



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.8, datë 21/05/2024

PËR

**KORRIGJIMIN E GABIMIT E LEJES PËR “PËR PËRDORIM
BURIMI UJOR”, ME NR. SERIE 00088 PËR PRODHIM
HIDROENERGJIE, DHËNË MË VENDIMIN NR.22 DATË
01.08.2023 PËR HEC ARRËZ, KACINAR, SIMON DHE HEC
SHPËRDHAZË, SUBJEKTI “SHPËRDHAZA ENERGJI” SHPK**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe referuar nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ” 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, sidhe të çdo kopje të njëhësuar të tij. Në këto kushte: Me kërkesë të subjektit dhe me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore pasi u konstatua se kërkesa e subjektit qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujor Mat ,

VENDOSI

1. Korrigjimin e gabimit material në “leje për përdorim burimi ujor” me nr.serie 00088, subjekti “SHPËRDHAZA ENERGJI ”SH.P.K. Leja

korrigjohet në periudhën e vlefshmërisë: Nga 31/05/2018 - 30/05/2023 në
“Sipas afatit të koncensionit”.

2. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përveç gabimit material (Nga 31/05/2018 - 30/05/2023 në “Sipas afatit të koncensionit”.)
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

